

LIGJ
Nr.7506, datë 31.7.1991

PËR INSTITUTIN E SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë veprimtaria e sigurimeve dhe e risigurimeve kryhet nga Instituti i Sigurimeve (INSIG), që është institucion shtetëror dhe varet nga ministri i Financave.

Neni 2

Sigurimet e detyrueshme catohen me ligj, kurse ato të pronës shtetëror me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Sigurimet vullnetare caktohen nga Instituti i Sigurimeve.

Objektet e rreziqet, tarifat, parimet, rregullat dhe kushtet e tjera që lidhen me sigurimet miratohen nga ministri i Financave me propozimin e Institutit të Sigurimeve.

Marrëdhëniet e siguresit me të siguruarin rregullohen me anë të kontratës së sigurimit.

Neni 3

Instituti i Sigurimeve ka të drejtë të bëjë:

a) Sigurimin e investimeve që kryhen në Republikën e Shqipërisë nga personat juridikë a fizikë të huaj, si dhe të pasurive që lidhen me to.

b) Sigurimin e pasurive të ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike e financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Instituti i Sigurimeve bën risigurime me shoqëri të sigurimeve e të risigurimeve të vendeve të tjera, në bazë të dispozitave të Këshillit të Ministrave.

Instituti i Sigurimeve ka të drejtë të marrë pjesë në rishpërndarjen e sigurimeve dhe të risigurimeve të shoqërive siguruese e risiguruese të vendeve të tjera.

Neni 5

Instituti i Sigurimeve ka të drejtë të lidhë marrëveshje ose të kryejë veprimtari të përbashkëta për sigurime e risigurime me shoqëri, institucione e organizata të shteteve të tjera.

Neni 6

Instituti i Sigurimeve ka këto organe:

a) Këshilli Administrativ

b) Drejtori i zëvendësit e tij.

Neni 7

Instituti i Sigurimeve drejtohet e përfaqësohet nga drejtori i cili vepron në përputhje dhe brenda kompetencave që i jepen nga Ministri i Financave, Këshilli Administrativ ose që përcaktohen në statusin e Institutit.

Instituti i Sigurimeve mund të përfaqësohet edhe nga persona të tjerë të autorizuar nga drejtori i Institutit.

Neni 8

Instituti i Sigurimeve ushtron veprimtarinë e tij ekonomike e financiare në mënyrë të pavarur. Me të ardhurat që realizon, ai përballon shpenzimet dhe i paguan shtetit tatimet e taksat e përcaktuara me ligj. Për pjesën tjetër të fitimit vendos Këshilli Administrativ i Institutit.

Instituti i Sigurimeve, për të përballuar nevojat e veta, të krijojë e të përdorë nga fitimi i tij fondin rezervë në lekë e valutë.

Bilanci i Institutit pasi miratohet nga Këshilli Administrativ, i paraqitet Ministrit të Financave.

Neni 9

Instituti i Sigurimeve është person juridik me qendër në Tiranë dhe ka rrjetin e tij në rrethe (degë e agjenci).

Degët e sigurimeve varen nga drejtori i Institutit të Sigurimeve dhe për kryerjen e funksioneve e të detyrave ato kontrollohen e japin llogari para tij.

Neni 10

Dekreti nr.6542, datë 29.4.1982 "Për sigurimin e ndërtesave shtetërore të dhëna me qira për banim", shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
RAMIZ ALIA